

VENDIM
Nr. 46, datë 19.3.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SHA PËR SHTYRJEN PËR NJË
PERIUDHË TRANZITORE TË AFATIT TË PAGESËS SË FATURAVE PËR BLERJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR, NGA ANA E OSHEE
SHA DHE ÇËSHTJE TË TJERA TË RREGULLIMIT**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 180 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.3.2019 mbasi shqyrtoi kërkesën e OSHEE sh.a., si dhe relacionin e drejtorive teknike, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe shqyrtoi çështjet e parashtruara nga përfaqësuesit e OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, si dhe argumentet e parashtruara nga përfaqësuesi i shoqërisë GEN-i Tirana sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019, nisur nga situata financiare në të cilën ndodhet, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për vendosjen e një periudhe tranzitore, për procedurat e blerjes së energjisë elektrike që do të zhvillohen nga OSHEE sh.a. deri në fund të vitit 2019, në mënyrë që pagesa e faturës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga kjo e fundit brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit dhe jo brenda 90 ditëve siç parashikohet në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, i ndryshuar.

- Shoqëria OSHEE sh.a. bën me dije si më poshtë:

- Ka vijuar me blerjen e energjisë elektrike gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor 2018, si dhe janar, shkurt, mars 2019, duke siguruar pjesën më të madhe të saj në treg të lirë, për shkak të mungesës së theksuar të prodhimit nga ana e shoqërisë KESH sh.a.

- Jo vetëm që nuk mundi të rikuperojë humbjet e shkaktuara nga thatësira e jashtëzakonshme e vitit 2017, e cila solli rritje të kostos së blerjes së energjisë elektrike, por edhe u përball me një kosto shtesë për blerjen e energjisë elektrike si pasojë e mungesës së furnizimit nga KESH sh.a. në pjesën e dytë të vitit, si dhe nga rritja e prodhimit të Prodhuesve të Pavarur të Energjisë Elektrike në pjesën e parë të vitit 2018. Mungesa e likuiditetit si pasojë e faktorëve sa më sipër e detyroi OSHEE sh.a. të ngadalësoje programin e investimeve në rrjet për vitin 2018, i cili është rreth 2 miliardë lekë më i ulët se ai i parashikuar në programin financiar të miratuar.

- Në të sajën sipër cituar, OSHEE-ja bën me dije se për periudhën janar–shkurt 2019, shpenzimet për blerje të energjisë elektrike ishin 3.714 miliardë lekë ose 29.6 milionë EURO me të larta se ato të planifikuara dhe sipas pritshmërive, kjo gjendje mund të vijojë edhe pjesën e parë të vitit 2019, gjë që ndikon në aftësinë paguese të saj.

- Shoqëria OSHEE sh.a. analizoi me shumë kujdes situatën e jashtëzakonshme dhe sipas këtyre analizave, parashikohej që gjatë muajve shkurt, mars, prill 2019 të përballej me pamundësi financiare të pagesës së faturave të blerjeve në treg të lirë, si pasojë e përplasjes së këtyre pagesave me faturat korrente të HEC-eve dhe KESH sh.a. gjatë muajve janar, shkurt, mars 2019, me afat pagesë 30 ditore, të cilët gjatë këtyre muajve parashikohet të rrisin dukshëm prodhimin e tyre.

- OSHEE sh.a. vlerëson se, risqet dhe dëmet që do të shkakttoheshin nga kjo situatë pamundësi e likuiditetit, të cilat lidhen me penaltetet që do të aplikoheshin nga shoqëritë tregtare të energjisë,

riskun e pamundësisë së blerjes së energjisë elektrike gjatë muajve shkurt, mars etj. 2019, si rezultat i debive të krijuara, do të sillnin përkeqësimin e reputacionit të shoqërisë OSHEE sh.a., si pasojë e mosrespektimit të kontratave ndaj shoqërive tregtare të energjisë.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës me nr. 64/3, datë 4.3.2019 përcolli në ERE shkresën e OSHEE sh.a. nr. 1785/1 prot., datë 31.1.2019, duke dhënë edhe rekomandimin për vlerësimin e propozimit të shoqërisë OSHEE sh.a., bazuar kryesisht në faktin që OSHEE sh.a. po përballet me një situatë mjaft delikate nga pikëpamja financiare.

- Këtij rekomandimi, i cili vjen në zbatim të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, por edhe në cilësinë e aksionarit të shoqërisë OSHEE sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE iu përgjigj shkresërisht për shkak të kohës së depozitimit të këtij rekomandimi, pas vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën për një ndryshim në “Rregulloren” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016.

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019 ka kërkuar dhe bërë me dije se nuk është parashikuar asnjë pagesë për investime, një pjesë e të cilave janë tashmë në vazhdim dhe pezullimi i të cilave do të shkaktonte kosto shtesë.

- E ndodhur në kushtet e rritjes së kostonë së blerjes së energjisë, si dhe analizën financiare për përballimin e situatës së krijuar, shoqëria OSHEE sh.a., në vlerësim të risqeve dhe dëmeve potenciale vlerëson të arsyeshme dhe imediate ndryshimin e afatit të pagesës për faturat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar nga ana e saj, duke e vendosur brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimin, për procedurat e blerjes deri në fund të vitit 2019.

- Duke e konsideruar të një rëndësie të veçantë stabilitetin financiar të shoqërisë OSHEE sh.a. edhe për sa i përket interesit publik që ka mbarëvajtja e kësaj shoqërie, si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Duke vlerësuar si potencial dëmin financiar (*cash flow*) që mund t'i shkaktohet shoqërisë në kushtet e pamundësisë paguese.

- Duke marrë në konsideratë rekomandimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vlerësimin e propozimit të shoqërisë OSHEE sh.a., për ndryshimin në termat e pagesës së parashikuar në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, në zbatim të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Duke vlerësuar se periudha tranzitore do të shtrihet për një kohëzgjatje jo më të madhe se periudha në të cilën parashikohet që shoqëria OSHEE sh.a. të ndodhet në kushtet e kryerjes së pagesave në masën më të lartë gjatë vitit kalendarik (mars–qershor), për shkak të detyrimit për blerjen e të gjithë energjisë së prodhuar nga Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Mbështetur në parashikimet e nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë: “Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin

publik”.

- OSHEE sh.a. bëri me dije se shoqëria KESH sh.a. me anë të shkresës nr. 1088 prot., datë 25.2.2019 sqaroi se, pasi rivlerësoi situatën hidrike në vend, planifikon të rishikojë programin e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 mars–31 dhjetor 2019. Nga parashikimet e raportuara nga KESH sh.a. në të sajën sipërcituar, sasia maksimale e prodhimit e garantuar për vitin 2019 me probabilitet suksesi 70% është në vlerën 2960 mw, ndërsa sasia e garantuar për të njëjtën periudhë, me probabilitet suksesi 80% është në vlerën 2633 mw.

- Mbështetur në parashikimet e VKM-së nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, parashikohet se në rastet kur FSHU-ja nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, FSHU-ja, ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. FSHU-ja kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguruar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.

- Duke qenë në dijeni të transaksioneve të energjisë së kryer mes OSHEE sh.a. dhe tregtareve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 1 janar 2019 deri në këtë vendimmarrje, nën termat e pagesës së deklaruar nga OSHEE sh.a. dhe të pranuar nga tregtarët pjesëmarrës në ankand e fitues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e zbatimit të nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, për sigurimin e energjisë elektrike nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.

2. Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandeve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike

3. Pagesa që OSHEE-ja do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë.

4. OSHEE sh.a. të informojë çdo fundmuaji në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.

5. OSHEE sh.a. të rishikojë programin e zhvillimit ekonomik në funksion të ndryshimeve të këtyre efekteve financiare të parashtruara në shkresën e shoqërisë nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019.

6. OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të cilët kanë dakordësuar dhe kryer shitblerjen e energjisë elektrike nën termat e ftesës së shpallur të OSHEE, që nga data 1 janar deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi të respektojnë reciprokisht termat e ftesës së shpallur të OSHEE sh.a. dhe të ofertave të pranuar të tregtarëve të energjisë elektrike.

7. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi